




Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivury	14.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTICK	6118/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.898/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësi, ka shqyrtuar ankesën A.nr.898/2021 të datës 01.11.2021, të parashtruar nga me adresë banimi fshati Rekë, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.12.2021, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.898/2021 e datës 01.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Punësimit, me datë 01.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 5223/2021, e regjistruar me numër A.nr.898/2021, për kompensimin e shtesave sipas Vendimit Nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të ardhmen si dhe në mënyrë retroaktive nga data e themelimit të marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.11.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Kosovës, ndërsa me datën 08.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto

prova: Ankesën A. nr.898/2021 e parashtruar më datë 01.11.2021, me numër protokoll 5223/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.11.2021; Parashtrësën për mos pagesën e shtesave sipas Vendimit të Qeverisë 02/39 të datës 08.10.2008 me numër protokoll 667/21 e datës 14.09.2021; Kërkesën për pagesën e shtesave sipas Vendimit të Qeverisë 02/39 të datës 08.10.2008 me numër protokoll 255 e datës 14.07.2021; Vendimin me nr. 01/39 i datës 08.10.2008; Vendimin me nr. 02/39 të datës 08.10.2008; Listën dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumë për këto pozita; Vendimin me Nr.03/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr 04/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr.05/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr.06/39 të datës 08.10.2008; Vendim me nr.07/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr.08/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr. 09/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr.10/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr. 11/39 të datës 08.10.2008 Politika e pronësisë për ndërmarjet publike në Kosovë; Vendimin me Nr.12/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr. 13/39 të datës 08.10.2008; Vendimin me Nr.07/29 të datës 31.07.2008; Akt Emërimit e datës 01.02.2012; Akt Emërimit e datës 01.01.2014; Akt Emërimi e datës 01.12.2017; Vendimin me Nr.01/357 të datës 28.05.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 08.11.2021; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Kërkesën me Nr.94 të datës 21.02.2019; Kërkesën për përcaktimin e shtesave të TI-së me nr. 248 të datës 15.02.2019; Akt Emërimit me Nr. protokoll 47 të datës 01.12.2017; Akt Emërimit me nr.protokoll 107 të datës 01.12.2017; Akt Emërimit me nr.protokoll 81 të datës 01.12.2017; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Diplomën me Nr.83 të datës 23.11.2007; Certifikatën e datës 16.05.2003; Certifikatën e Cisco Systems e datës 01.11.2003; Certifikatën e Cisco Systems e datës 08.18.2002; Certifikatën e datës 31.05.2004; Certifikatën nga Qendra trajnuese dhe profesionale për kompjuter për F.H.; Certifikatën nga Qendra trajnuese dhe profesionale për kompjuter për F.H.; Certifikatën e datës 15.09.1998; Certifikatën e datës 30.07.2001; Mirënjohjen e datës 12.03.2004; Mirënjohjen e datës 10.12.2008; Certifikatën nga Computer Eorld Vision për N.J.; Diplomën me Nr.82 të datës 05.06.1985; Diplomë me Nr.476 e vitit 1997; Certifikatën e datës 24.01.2005; Certifikatën e datës 17.01.2004; Certifikatën e datës 19.08.2004; Certifikatën e datës 25.05.2004; Certifikatën e datës 20.12.2010; Certifikatën e datës 07.10.2006; Certifikatën nga Cisco për Certifikatën nga Microsoft për Certifikatën nga Microsoft për Diplomën me Nr. 7302 i të datës 23.03.2012;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **pa**bazuar, **sepse:**

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit me nr.prot.218 të datës 10.02.2012, ka themeluar marrëdhënia të punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pozitën e punës "Asistent i Teknologjisë Informative", në Qendrën Regjionale të Punësimit në Mitrovicë, ndërsa me datë 28.12.2017, ankuesit i është lëshuar Akt Emërimi me nr.1848, në pozitën e punës "Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative", në Zyrën e Punësimit në Mitrovica në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill pretendon se: që nga themelimi i marrëdhënies së punës në vitin 2012 nuk ka realizuar shtesat për IT siç përcaktohet me Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Kosovës, duke shtuar me tej se i njëjti i është drejtuar me kërkesë me shkrim institucionit punëdhënës për kompensimin



e shtesave te IT-së, por që asnjëherë nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e tij. Propozon që Këshilli ti njoh te drejtën e kompensimit të shtesave të IT-së për të ardhmen dhe në mënyrë retroaktive nga data e themelimit të marrëdhënies se punës.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka konstatuar se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitive në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut

duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitive përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.898/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

